



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Drejtoria e Rregullimit Teknik-

V E N D I M

Nr.2260, datë 07.02.2013

Për

“Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit””

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- | | | | |
|---------|--------|------------|---------|
| 1. Z. | Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. | Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. | Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. | Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. | Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 07.02.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, mori në shqyrtim, çështjen me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit””

BAZA LIGJORE:

1. Neni 7 germa e) dhe neni 110 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (në vijim Ligji 9918), “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (**ligji nr. 9918**);

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi dokumentin për këshillim publik “Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit”” ;
2. Dokumenti për këshillim publik “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit”;
3. Projektvendimi përkatës, si dhe diskutimet në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se :

1. Dokumenti për këshillim publik “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.
Hartimi i dokumentit është bazuar në nenin 7 gërma e) dhe neni 110 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (ligji nr. 9918),
2. Qëllimi rregullator mbi “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” është që ti përgjigjet:
 - Ndryshimeve të mëdha demografike që kanë ndodhur në Shqipëri dekadën e fundit veçanërisht rritja e madhe e popullimit të zonave urbane si Tirana, Durrësi etj.
 - Ndryshimeve që kanë ndodhur në lidhje me numeracionin (kodet e harmonizuar në nivel europian, kodet e drejtimit, numrat për shërbimet me vlerë të shtuar etj.);
 - Përditësimit të gjitha anekseve, pjesë e PKN, kryesisht i atyre që kanë të bëjnë me Kodin Kombëtar të Drejtimit (National Destination Code-NDC);
 - Reflektimit të ndikimeve në PKN të migrimin të rrjeteve TDM në rrjetet NGN;

Si dhe të krijojë një kuptim më të qartë për impaktin që do të kenë ndryshimet në PKN ;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Periudha e këshillimit publik do të jetë 30 ditë nga dita e publikimit zyrtar të këtij dokumenti në faqen e internetit të AKEP.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____

**DOKUMENT PËR KËSHILLIM PUBLIK
SHKURT 2013**

Struktura e dokumentit:

- Baza ligjore
- Panorame e pergjitheshme
- Plani aktual i Numeracionit
- Aresyet e rishikimit te Planit Kombetar te Numeracionit (PKN)
- Efektet e ndryshimit te PKN
- Fushata publicitare per implementimin e ketij ndryshimi ne PKN

1. Baza ligjore:

Neni 7 germa e) dhe neni 110 te ligjit nr.9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, (ne vijim Ligji 9918).

Periodha e konsultimit publik do te jete 30 dite nga dita e publikimit zyrtar te ketij dokumenti ne faqen e internetit te AKEP. AKEP mirepret komentet e paleve te interesuara ne lidhje me kete dokument brenda afatit te konsultimit publik.

Sektori i Telekomunikacioneve eshte ne transformim te vazhdueshem i karakterizuar nga rritja e shpejte dhe zhvillimeve teknologjike. Paradigma e re eshte konvergjenca e telekomunikacioneve, IT dhe broadcastit. Duke qene te ndergjegjishem qe disa nga keto zhvillime kane impakt ne Planin Kombetar te Numeracionit, AKEP sugjeron rishikimin e tij dhe nepermjet tij kerkon te arrije nje transparence me te larte dhe eficence gjithashtu.

Plani i numeracionit ne sektorin e telekomit per nje vend eshte nje plan fundamental i rendesishem qe kerkon kujdes dhe pergjegjesi ne rishikim per te pasur nje perkim me kerkesat e rritjes se tregut te telekomunikacioneve dhe zhvillimeve te reja. Planifikuesit duhet te marrin ne konsiderate kerksat per shtrijen e sherbimeve ekzistuese, futjen e sherbimeve te reja, si dhe te marrin parasysh kerkesat per projektet e ardhshme.

Qellimi i rishikimit eshte te analizoje ndryshimet qe afektojne PKN dhe te identifikojne rruget ne te cilat rregullimi i PKN dhe politika e alokimit te rrisin eficencen e perdorimit.

Per pergatitjen e ketij dokumenti AKEP eshte asistuar edhe nga ITU (International Telecommunication Union) me specialiste te fushes se numeracionit ne kuader te projektit te perbashket per rishikimin e PKN. Ne bashkepunim me ITU u organizua ne Shqiperi nje "workshop" me pjesemarrjen e sipermarresve te tregut te komunikimeve elektronike dhe AKEP. Gjate seminarit u zhvilluan edhe takime te vecanta ne grupe me specialistin e ITU. Gjithashtu jane organizuar takime me sipermarresit dhe ju eshte kerkuar mendim per ceshtje te ndryshme te PKN.

2. Panorame e pergjithshme, te dhena mbi tregun

Numri ne total i sipermarresve te regjistruar ne AKEP ne perputhje me regjimin e autorizimit te pergjithshem deri ne fund te 6 mujorit te I-re 2012, rezulton te jete gjithesej 137.Referuar "Rregjistrin e Sipermarresve" ne lidhje me njoftimin per ofrim rrjetesh/sherbimesh gjendja ne perputhje me regjimin e autorizimit te pergjithshem, rrjete dhe sherbime te specifikuara deri ne fund te 6 mujorit te I-re 2012, jane si me poshte:

- Ofrim shërbimi publik telefonik të lëvizshëm – 4 sipërmarrës;
- Ofrim shërbimi publik telefonik te levizshem (UMTS) (3G) – 3 sipërmarrës;
- Ofrim shërbimit publik telefonik fiks (të qëndrueshëm)– 82 sipërmarrës;
- Ofrim shërbimi të aksesit në Internet – 115 sipërmarrës;
- Ofrim shërbimi transmetim te dhenash – 47 sipërmarrës;
- Ofrim të linjave me qera – 21 sipërmarrës;
- Ofrim shërbimi te kartave te parapaguara – 5 sipërmarrës;

2.1 Investimet

Përsa u perket investimeve të kryera në vitin 2011, tabela e mëposhteme paraqet të dhënat sipas deklarimeve të operatorëve. Rritje të ndjeshme në krahasim me 2010 paraqesin investimet në rrjete fikse dhe fibrat optike për rrjete backbone.

Tabela 1: Investimet e operatoreve të komunikimeve elektronike (2012/1)

	2010	2011
Investime në infastrukturë të rrjetet fikse:	1,820	3,254
Rrjet telefonik PSTN/ISDN	524	427
Rrjet IP (ISP), platforma IP	222	1,434
Infrastrukture rrjet backbone FIBER OPTIKE	1,074	1,393
Investime në infastrukture rrjeti celulare	8,089	6,831
Total	9,909	10,085

3. Telefonia celulare

3.1 Numri i pajtimtarëve

Në fund të 6 mujorit të I-re 2012, numri i pajtimtareve të telefonise se levizshme (ne total) arriti ne afersisht 5.3 milion ne krahasim me 5.2 milion ne fund te vitit 2011, e cila perben nje norme penetrimi afersisht 187% kundrejt normes se penetrimit 185 %, qe ishte ne fund te vitit 2011. Ne totalin e tyre, ne fund te 6 mujorit te I-re 2012 ka nje rritje prej rreth 55 mije perdorues celulare krahasuar me fund vitin 2011 ose nje prej afersisht 1%.

Numri i pajtimtarëve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe politikat e operatorëve janë që një kartë SIM mund të jetë aktive për një vit nga momenti kryerjes së thirrjes së parë, dhe nëse koha e bisedës përfondon para aftit 1 vjecar pajtimtari mund të marrë thirrje hyrëse për 6 muaj. Ndërkohë nëse do ti referoheshim numrit të pajtimtarëve që

kanë kryer komunikim në tre muajt e fundit (përdorues aktivë), numri i pajtimtarëve celularë në fund të 6 muajit të I-re 2012 është 3,238,369 (norma e penetrimit do të ishte afërsisht 114%), krahasuar me 3,108,087 (norma e penetrimit 110%) në fund të vitit 2011.

Ne tre rrjetet Vodafone, Eagle Mobile dhe Plus Communication gjatë 6 muajit të I-re 2012 ka rritje të numrit të pajtimtarëve në rrjetet e tyre, përkatesisht me 1.65% Vodafone, 17.5% Eagle Mobile dhe 3.5% Plus Communication. Kurse rrjeti AMC ka një rënie në numrin e pajtimtarëve në fund të 6 muajit të I-re 2012 krahasuar me fund vitin 2011, prej rreth 9.5 %.

3.2 Shërbime të reja: 3G

Aktualisht në tregun e shërbimeve 3G janë prezent tre rrjete, Vodafone Albania, AMC dhe Eagle Mobile. Referuar të dhënave të derguara për 6 muajin e I-re 2012, rezultojnë që numri i pajtimtarëve që aktualisht përdorin shërbime 3G është mbi 308 mijë nga të cilët rreth 38 mijë përdorin shërbimet 3G nëpërmjet card/modem, ndërsa pjesa tjetër nëpërmjet aparatit të telefonit celular. Krahasuar me 6 muajin e I-re 2011 periudhë në të cilën ishte prezent me shërbime 3G vetëm Vodafone Albania, në fund të vitit 2011 dhe 6 muajin e I-re 2012 ka një vijimesi rritje të numrit të pajtimtarëve në shërbime 3G, por edhe vihen re elementet e reja ofertuese për këto shërbime nga dy operatorët prezent në treg.

Vihet re që numri i përdoruesve që përdorin shërbimet 3G me kartë modem/USB 3G, gjë e cila lejon aksesin në internet nëpërmjet PC është rreth 38 mijë që përben rreth 21 % të pajtimtarëve total (fiks dhe 3G) me akses broadband në Shqipëri.

Tabela 4: Tregues të ofrimit të shërbimeve 3G (2011).

	AMC	VODAFONE	TOTAL
Numri pajtimtarëve të telefonisë mobile me akses në Internet broadband UMTS në total:	76,850	231,441	308,291
nëpërmjet aparatit të telefonit celular	65,000	205,520	270,520
nëpërmjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)	11,850	25,921	37,771

4. Telefonia fikse

4.1 Numri i pajtimtarëve

Telefonia fikse në ndryshim nga telefonia celulare dhe Interneti, ka pësuar rënie në numrin e pajtimtarëve, dhe vazhdon të ketë një penetrim shumë të ulët.

Në fund të 6 mujorit të I-re 2012, numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse arriti në rreth 325 mijë, nga të cilët 244 mijë të Albtelecom dhe rreth 81 mijë pajtimtare për operatorët alternativë. Vihet re një reduktim në krahasim me rreth 339 mijë që ishin në fund të vitit 2011. Ky reduktim është afërsisht rreth 14 mijë pajtimtare dhe erdhi si rezultat i reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me rreth 15 mijë pajtimtare, por sic vihet re ka një rritje të vogël të numrit të pajtimtarëve të rrjeteve të operatorëve alternativë.

Referuar këtyre të dhënave, rezulton që penetrimi i telefonisë fikse në fund të 6 mujorit të I-re 2012 është afërsisht 11.5 %, krahasuar me 12% që ishte në fund të vitit 2011.

5. Numrat dhe seritë numerike

5.1 Administrimi i numrave dhe kodeve mbështetëse

- a) Ligji nr.9918, datë 19.5.2008- “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” mbështetur në nenet 80 deri në 90.
- b) Rregullore për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike dhe Planit kombëtar të numeracionit” miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr.932 dt.11.08.2009, hyrë në fuqi më 01.09.2009 publikuar në faqen e web të AKEP, www.akep.al.
- c) Plani i numerformimit është një plan i hapur.
- d) Plani kombëtar të numeracionit ka implementuar vendime dhe rekomandime të ITU, ECC, EC

5.2 Caktimi i numrave bëhet me dy mënyra

- a- caktimi i drejtpërdrejtë ku AKEP cakton numra individualë për përdoruesit,
- b- caktimi sipas procesit të alokimit paarsor dhe dytesor:

Formulari i aplikimit për numra/kode ose seri numerike është i publikuar në faqen e web të AKEP. Është i kuptueshëm dhe lehtësisht i plotësueshëm.

AKEP vendos për miratimin apo refuzimin e aplikimit për numër/kod apo seri numerike brenda një periudhe 20 ditore.

Pagesa per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe serive numerike kryhet mbeshtetur ne VKM nr.599, date 23.07.2010 i ndryshuar me VKM nr. 911, datë 19.12.2012.

Rregullat per administrimin e kodeve te pikave te sinjalizimit kombetare (nspc) dhe nderkombetar (ispc) per interkoneksionin e rrjeteve me Vendimin Nr.1257, datë 16. 04. 2010 te Keshillit Drejtues te AKEP.

5.3 Portabiliteti i numrit ne kete treg

Eshte implementuar portabiliteti i numrit si per te numrat e levizshem ashtu edhe ate fiks.

6 Plan aktual i numeracionit

PKN eshte nje plan themelor ashtu si komutimi, rrugezimi, transmetimi, tarifimi, sinkronizimi etj. Nje rishikim i pergjithshem i Planit te Numeracionit eshte bere ne vitin 2001. Ai plan ashtu si edhe ne praktikat e njohura te vendeve te tjera perkoi me topologjine e rrjetit te operatorit te vetem te telefonise fikse – sot Albtelecom. Dmth ai plan u rishikua ne nje kohe kur nuk kishte konkurrence ne sherbimet baze te telekomunikacioneve, konkurrenca ne telefonine e levizshme pothuajse nuk kishte nisur, sherbimi i internetit pothuaj ishte padisponueshem ne te gjithe vendin.

Me vone ky plan u rishikua ne vitin 2008. Ky proces u asistua nga nje konsulence nderkombetare. Duhet theksuar se dokumenti per rishikimin dhe ceshtjet thelbesore te tij u miratuan duke kaluar ne procesin e keshillimit publik. Por ky rishikim ne thelb nuk u mor me planin me shume se sa u mor me Rregulloren per administrimin e numrave. Planit ju shtuan disa kategori te reja numrash dhe ju bene disa pershtatje me numrat e harmonizuar ne nivel europian.

Keshtu kufijte e numraconit aktual jane si me poshte:

- 1 – Fiks gjeografik
- 2 – Fiks gjeografik
- 3 – Fiks gjeografik
- 4 – Fiks gjeografik
- 5 - Fiks gjeografik
- 6 – I levizshem
- 7 – Fiks jo - gjeografik (VoIP)
- 8 – Fiks gjeografik

9 - Fiks gjeografik por i pa perdorur

Plani Kombetar i Numeracionit (PKN) ekzistues eshte hartuar nga ERT (sot AKEP) ne vitet 2000-2001, ne zbatim te Nenit 66 te Ligjit Nr. 8618, date 14.6.2000- "PER TELEKOMUNIKACIONET NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE" dhe ne perputhje me rekomandimet perkatese te strukturave te KE ne fushen e telekomunikacioneve (te tilla si ETO-European Telecommunication Office, ECTRA-European Committee for Telecommunications Regulatory Affairs, etj.). Sipas ketyre rekomandimeve PKN eshte hartuar qe te jete funksional te pakten per 10 deri 15 vite. Me kete rast duhet theksuar se P.K.N. ka perballuar me sukses kerkesat e tregut te liberalizuar telekomunikacioneve ne R.SH. duke mos ndjere shterimin e numrave dhe serive numerike si dhe deri ne nje mase te konsiderueshme, ka perballuar zhvillimet teknologjike ne kete fushe. Megjithate, sot mbas 12 vitesh te hartimit te PKN, mendojme se eshte momenti per rishikimin e tij. Nder aresyet kryesore qe e bejne te nevojshme kete rishikim jane:

- a) Zhvillimet teknologjike ne fushen e komunikimeve elektronike dhe ndryshimet ne teknologjine e rrjeteve, kalimi ne rrjetet NGN (Next Generation Network), kane influencuar ne ndryshimin e kostove dhe si rezultat i kesaj ne shume vende tarifat me pakice kane filluar te jene te pavarura nga distanca (Raporti i CEPT-ECC 154-Evoluimi i Numrave Gjeografike-Qershor 2010).
- b) Mundesia e zvogelimit ose heqjes se informacionit gjeografik ne permbajtjen numrave si nje menyre per rritjen e efikasitetit te perdorimit te skemes se numeracionit dhe te krijimit te zonave te gjera ose shtrirjen e portabilitetit ne hapesira te gjera vendore (Raporti i CEPT-ECC 154-Evoluimi i Numrave Gjeografike-Qershor 2010).
- c) Verejtje nga Operatore te ndryshem qe ofrojne sherbimin telefonik publik te qendrueshem, kryesisht nga Albtelecom, per ristrukturimin e zonave numerike (NDC), duke e ulur numrin e tyre.
- d) Futja ne tregun e komunikimeve elektronike te sherbimeve te konverguara fiks-mobile(FMC) te cilat mund te kerkojne seri numerike te reja, si dhe nevoja per te hedhur veshtrimin matane kufijve te kornizes aktuale rregullatore te BE(Raporti i CEPT-ECC REPORT 87-E ardhmja Planeve te Numeracionit E.164-Shtator 2006), etj.
- e) Rezultatet e Grupit te Punes per "Rishikimin e Planit Kombëtar të Numeracionit", në zbatim të Urdhërit Nr.622, datë 30.09.2010.

Duke konsideruar qe synimi kryesor i PKN eshte lehtesimi i zhvillimeve teknologjike dhe komerciale, eshte e nevojshme ndermarrja ne kohe e hapave te pershtateshme per kete qellim. Detyrimi dhe pergjegjesia e AKEP per rishikimin e P.K.N., shoqerohet edhe me detyrimin per njohjen e gjendjes ekzistuese, per te minimizuar ne kete menyre efektet rrjedhoje tekniko-ekonomike dhe sociale, qe sjell implementimi i nje P.K.N. te ri.

6.1 Struktura ekzistuese e Planit Kombetar te Numeracionit (PKN)

6.1.1 Kriteret ku eshte bazuar hartimi i PKN:

Ne lidhje me serite numerike ne dispozicion, gjatesine, menyren e perftimit te NDC-ve me gjatesi te ndryshme etj., jane zbatuar rekomandimet e ECTRA-s, te cilat shkurtimisht permblihen:

- a) Ne skemen e hapur te numeracionit, ne diapazonin e NDC vleresuar si pjesa e pare e N(S)N (National Significant Number), serite 2,3,4,5,8,9 perdoren per NDC gjeografike dhe jo-gjeografike, ndersa serite 6,7 perdoren vetem per NDC jo-gjeografike;
- b) Nje seri eshte lene dhe lihet e lire per te mundesuar transformimin komod nga Plan i Hapur ne Plan te Mbyllur Numeracioni. Kjo eshte seria 1. Ne kete rast, seria 1 do te zevendesoje destinimin e serise perkatese te percaktuar per shfrytezim sipas pikes se mesiperme.
- c) Gjatesia e NDC, ndonese teorikisht mund te jete jo me shume se me 5, dhe ne raste teper te veçanta me 6 shifra, praktikisht eshte kufizuar deri ne 3 shifra (pra me 1, 2 dhe 3 shifra). NDC me gjatesi te ndryshme perfitohen nepermjet bashkimit/ndarjes se elementeve matricore baze, me kusht qe elementet qe bashkohen/ndahen te mos shfrytezohen si NDC.
- d) Per te mundesuar kalimin nga Plan i Hapur ne Plan te Mbyllur Numeracioni, si dhe shfrytezimin efektiv te burimeve te NDC-ve, gjatesia e Numrit Sinjifikativ Kombetar ($N(S)N=NDC+SN$) qe duhet te jete fikse dhe e njejte per te gjithë abonentet eshte percaktuar me tete shifra. Kjo per kushtet e skemes uniforme te numeracionit.
- e) Sasia e NDC gjeografike eshte percaktuar ne 170.

6.1.2 Parimet ku eshte bazuar zgjidhja konkrete e PKN:

- a) Secila zone urbane (Bashki Baze dhe Bashki e Vogel) e 36 rretheve ka nje NDC te vecante.
- b) Ne zonen rurale (Komunat) te secilit rreth, nje ose disa komuna kane NDC te veçante. Perfshirja e me shume se nje komune ne nje NDC te kushtezohet nga numri i banoreve dhe fqinjesia gjeografike.

Kjo zgjidhje mbeshtetet ne shfrytezimin e 9 elementeve (nga i dyti deri tek i dhjeti) te mundshem per shfrytezim per NDC gjeografike ne te 6-ta serite (2, 3, 4, 5, 8 dhe 9).

36 rrethet e vendit te grupuara ne 5 grupe qe diferencohen nga njeri tjetri nepermjet shifres se pare te NDC, ne perputhje me serine e zgjedhur. Zonat urbane dhe rurale brenda secilit rreth diferencohen dhe identifikohen nepermjet shifres se dyte te NDC, dhe konkretisht:

- Zone urbane–Bashki Baze: shifra e dyte e NDC eshte 1, 2, 3, 4 ose 5.

- Zone urbane–Bashki e Vogel: shifra e dyte e NDC eshte 6, 7, 8 ose 9;
- Zone rurale–Komune: shifra e dyte e NDC eshte 6, 7, 8 ose 9

Formati i NDC-ve eshte:

- Zone urbane–Bashki Baze: formati me 2-shifra (XX), me mundesi kalimi ne formatin me 1-shifer (X) vetem per bashkine baze te Tiranes.
- Zone urbane–Bashki e Vogel: formati me 3-shifra (XXX), te perfituara nga zberthimi me nje rend vijues i elementeve nr.7, 8, 9, dhe 10 (pas shifres se dyte) te seciles seri.
- Zone rurale – Komune : formati me 3-shifra (XXX), te perfituara nga zberthimi me nje rend vijues i elementeve nr. 7, 8, 9 dhe 10 (pas shifres se dyte) te seciles seri.

Formati i NSN, per te plotesuar vleren e kerkuar (3) te treguesit SN/NB, ne kufijte e ketij Plani Numeracioni eshte me 8-shifra.

6.1.3 Karakteristikat permbledhese te PKN.

a) Kriteret organizative baze jane:

- Secila zone urbane – Bashki Baze e 36 rretheve ka nje NDC te vecante.
- Zona urbane – Bashki te vogla ne pikpamje te numeracionit konsiderohen te perfshira ne zonen rurale te rrethit perkates dhe identifikohen me NDC nga i njejti spekter numerik ku zgjidhen edhe NDC e zonave te numeracionit rural.
- Zonat e numeracionit rurale (Bashki e Vogel/Bashki e Vogel + Komune/Komune +Komune) kushtezohen nga numri i banoreve dhe fqinjesia gjeografike.

b) Eshte parashikuar shfrytezimi i 9 elementeve (nga i dyti deri tek i dhjeti) te mundeshem per shfrytezim per NDC gjeografike ne te 5-ta serite (2, 3, 4, 5 dhe 8). Seria 9 (elementi i dyte deri tek i dhjeti) jane te lire. Serite 6, 7 jane plotesisht ne dispozicion te NDC jo-gjeografike. Elementet e pare te serive (X0) ku X=2 9 jane ne dispozicion te Kodeve te Shkurter per sherbimet jo-gjeografike, per sherbimet/rrjeta te perzier, per rrjeta jo-telefonike apo sherbime te tjera.

c) Pervec grupimit te 36 rretheve te vendit ne 5 grupe qe diferencohen nga njeri tjetri nepermjet shifres se pare te NDC, ne perputhje me serine e zgjedhur, zonat urbane dhe rurale brenda secilit rreth diferencohen dhe identifikohen nepermjet shifres se dyte te NDC dhe konkretisht:

- Zona urbane – Bashki Baze: shifra e dyte e NDC eshte 1, 2, 3, 4, dhe 5.
- Zona urbane – Bashki e Vogel+Zona Rurale- Komune: shifra e dyte e NDC eshte 6, 7, 8 dhe 9.

d) Formati i NDC-ve eshte:

Zona urbane–Bashki Baze: me 1-shifer (X) vetem per Bashkine baze te Tiranes; te tjerat me 2-shifra (XX) dhe me 3-shifra (XXX)

Zona urbane–Bashki e Vogel:formati me 2-shifra (XX) vetem per BV te Tiranes; te tjerat-formati me 3-shifra (XXX).

Zona rurale – Komune : formati me 2-shifra (XX) vetem per Komunat e Tiranes; te tjerat-formati me 3-shifra (XXX).

e) Seria 1 ne diapazonin e NDC lihet e lire per transformim te Llojit te Planit te Numeracionit (nga Plan i Hapur ne Plan te Mbyllur).

f) Sasia e zonave te numeracionit, sasia dhe formati perkates i NDC-ve:

Vendi eshte ndare ne 170 zona numeracionio, ku seicila ka nje kod te vecante NDC- National Destination Codes (Kodi i Drejtimit Kombetar):

	Ndarja administrative dhe numeracioni	Zona total (NDC)	Sasia ne perputhje me formatin		
			X	XX	XXX
a.	Zona Urbane (Bashki)	36	1	14	21
b.	Zona Urbane (Njesi Bashkiake)	20	-	-	20
c.	Zona te perziera (njesi bashkiake + komuna)	7	-	1	6
ç.	Zona rurale (Komuna)	107	-	2	105
Total:		170	1	17	152

6.1.4 Kategorite e numrave dhe serive numerike

Nr	Kategorite e numrave sipas llojit te sherbimit
01	Numra gjeografike
02	Numra te levizshem
03	Numra te shkurter (115XX, 116 XXX, 11X-19X)
04	Numer personal (700 11xxxx)
05	Numrave të gjelbër (800xxxx)
06	Numra per kartat telefonike (801xxx)
07	Numrat blu (808xxx)
08	SMS me vlerë të shtuar (5xxxx)
09	Numra per shërbime me vlerë të shtuar (900xxx)
10	Prefikset e përzgjedhjes së bartësit (10xx)
11	Prefikset e rrugëzimit per portabilitetin e numrit (99xx)
12	Kod i pikes nderkombetare te sinjalizimit (ISPC - International Signalling Point Code)
13	Kod i pikes kombetare te sinjalizimit (NSPC - National Signaling Point Code)
14	Kod i rrjetit mobil (MNC - Mobile Network Code)

7. Arsyet e rishikimit te planit kombetar te numeracionit (pkn):

Bazuar ne:

7.1 Orientimet Kryesore te Raporteve te CEPT-it per te ardhmen e PKN

7.1.1 Raporti i CEPT-ECC 154-Evoluimi i Numrave Gjeografike(Qershor 2010).

Sherbimi i linjave gjeografike te telekomunikacionit tradicionalisht ka perdorur numrat gjeografike. Zhvillimi i konkurnces ne sherbimet gjeografike ka çuar ne rritjen e shpejte te kerkeses per blloqe numrash dhe ka krijuar uljen e rezerves se numrave ne disa zona duke i detyruar Rregullatoret te marrin vendime per ndryshimet e nevojshme per sigurimin e nje rezerve te mjaftueshme te numrave. Ne te njejten kohe ka ecur perpara edhe teknologjia e rrjeteve duke influencuar ne ndryshimin e kostove dhe si rezultat i kesaj ne shume vende tarifatat me pakice kane filluar te jene te pavarura nga distanca.

Te gjitha keto ndryshime kane detyruar Rregullatoret te rishikojne planet e tyre te numeracionit dhe disa prej tyre jane duke e hequr informacionin gjeografik ne permbajtjen numrave ne planet e tyre te numeracionit.

Ky dokument:

- Ofron nje histori te shkurter te numrave gjeografike duke shpjeguar strukturen e tyre dhe kufizimet aktuale;
- Pershkruan dhe shtjellon ne detaje mundesine e heqjes se informacionit gjeografik ne permbajtjen numrave si nje menyre per rritjen e efikacitetit te perdorimit te skemes se numeracionit dhe te lejoje krijimin e zonave te gjera ose shtrirjen e portabilitetit ne hapësira te gjera vendore.

Dokumenti tregon qe:

- Heqja ose zvogelimi i kerkesave gjeografike per perdorimin e numrave e ben me shume eficient perdorimin e blloqeve numerike;
- Heqja ose zvogelimi i kerkesave gjeografike per perdorimin e numrave gjithashtu ben te mundur shtrirjen e portabilitetit ne hapësira te gjera, por normalisht eshte vendimi komercial i operatoreve per ta ofruar portabilitetin brenda rrjeteve te tyre. Teknologjia qe nevojitet, eshte e njejta sikurse ajo qe perdorin ofruesit e sherbimit te portabilitetit. Ne kete kontekst mund te jete e pershtatshme futja e nje ofruesi te perbashket per portabilitetin dhe nje baze te dhenash reference qe te permbaje te gjithe numrat.
- Alternativat per heqjen e informacionit gjeografik nga plani i numeracionit ne rastet kur kerkohet zgjidhje per nje situatë te shterimit te rezerves se numrave jane zvogelimi i blloqeve te numrave ose mbyllja e planit te numer formimit.
- Ekzistojne disa rruge te ndryshme per zvogelimin ose heqjen e kerkesave per informacionin gjeografik. Duke konsideruar qe synimi kryesor i planit te numeracionit eshte lehtesimi i zhvillimeve teknologjike dhe komerciale, eshte e nevojshme ndermarrja ne kohe e hapave te pershtatshme. Kjo do te mund te perputhte kerkesat e perdoruesve dhe operatoreve te rinj ose mund te zgjidhte nevojen per numra, por do te kufizonte efektet negative per perdoruesit fundore dhe operatoret.
- Procesi i heqjes (graduale) se informacionit gjeografik nga plani i numeracionit eshte ne vartesi te kushteve specifike te tregut dhe situates qe lidhet me nivelet e kapaciteteve te perdorura brenda planit ekzistues te numeracionit.
- Plani i numerformimit nuk eshte i lidhur me heqjen e informacionit gjeografik ne permbajtjen e numrave, megjithate efekti i heqjes se informacionit gjeografik ne permbajtjen numrave mund te jete ne vartesi nga fakti qe plani i numer formimit eshte i hapur ose i mbyllur.

7.1.2 Raporti i CEPT-ECC REPORT 87-E ardhmja Planeve te Numeracionit E.164 (Shtator 2006)

Rekomandimi i ITU-T E.164 eshte baza mbi te cilin strukturohen Planet e Numeracionit sikurse eshte strukturuar Plani Kombetar i Numeracionit.

Dokumenti fokusohet ne numrat E.164 si dhe:

- Konkurenca ne ofrimin e sherbimeve te telefonise ne zona te caktuara gjeografike ka rritur kerkesen per numra e per rrjedhim nevojën per nje rishikim per perdorim sa me efikas.
- Avancimet ne teknologjike e rrjeteve nder te tjera kane sjelle kerkesen per rregullime tarifore

AKEP mendon se eshte koha per rishikimin e PKN.

Nder ceshtjet kryesore te cilat AKEP i mendon sit e tilla mund te permendim:

- a) Ndryshimet e medha demografike qe kane ndodhur ne Shqiperi dekadën e fundit vecanerisht rritja e madhe e popullimit te zonave urbane si Tirana, Durresi etj.
- a) Ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me numeracionin (kodet e harmonizuar në nivel europian, kodet e drejtimit, numrat për shërbimet me vlerë të shtuar etj.);
- b) Përditësimin e të gjitha anekseve, pjesë e PKN, kryesisht i atyre që kanë të bëjnë me Kodin Kombetar te Drejtimit (National Destination Code-NDC);
- c) Reflektimin e ndikimeve në PKN të migrimit të rrjeteve TDM të Albtelekom-it dhe operatorëve të tjerë në rrjetet NGN;
- d) Trajtimin e çështjeve të VoIP;
- e) Trajtimin e çështjeve të tarifës së terminimit, konvergjencën e tarifës “Local and long distance”, çmimit “on-net and off-net” etj., dhe pasqyrimin e ndikimeve të tyre në PKN.


AKEP per trajtimin e ketyre ceshtjeve ka organizuar disa takime ne nivel ekspertesh me sipermarres te tregut te komunikimeve elektronike. Gjate vitit 2012 AKEP ne vijim te ketij procesi te nisur dhe mjaft te rendesishem eshte asistuar edhe nga ITU me specialiste te fushes perkatese. Ne kete kuader u zhvillua edhe nje workshop ne Tirane me pjesemarrjen e perfaqesuesve nga tregu i komunikimeve elektronike.

Propozimi i AKEP, duke marre ne konsiderate edhe nga rekomandimet e ECC eshte qe se pari te rrise siperfaqet e zonave gjeografike **ose ndryshe reduktimi i kerkesave per informacionin gjeografik** ne perdorimin e numrave (rajonet) dhe pa prekur ne thelb planin e

numer formimit. Kjo do te ule efektet negative dhe shqetesimet qe mund ti lindin konsumatorit me ndryshimet e propozuara.

7.1.3 Rritja e siperfaqeve te zonave gjeografike ose reduktimi i kerkesave gjeografike:

- Heqja ose reduktimi i kerkesave gjeografike per perdorim te numrave ben perdorimin e blloqeve te numrave shume me efikase.
- Heqja ose reduktimi i kerkesave gjeografike per perdorim te numrave gjithashtu e ben te mundshme nje zone te gjerë te portabilitetit.
- AKEP mendon se rritja e siperfaqeve te zonave gjeografike dmth nje siperfaqe me e madhe do te sherbehet nga me shume se nje NDC, shih figuren e meposhtme:



Perpara:

- NDC A eshte ekskluzive per zonen 1
- NDC B eshte ekskluzive per zonen 2
- NDC C eshte ekskluzive per zonen 3

Pas:

- NDC A mund te perdoret ne zonen 1,2 dhe 3
- NDC B mund te perdoret ne zonen 1,2 dhe 3
- NDC C mund te perdoret ne zonen 1,2 dhe 3

7.1.4 Efektet e numer formimit lokal

Perocedura e **numer formimit lokal** ne Shqiperi eshte pak komplekse krahasuar me disa vende te tjera per shkak se NDC jane te gjatesive te ndryshme. Ndryshimet e propozuara nuk kerkojne qe te behet ndonje ndryshim ne **numer formimin lokal** pasi procesi eshte algoritmik dhe jo gjeografik. Procesi megjithate eshte pak kompleks dhe kerkon disa njohje te gjatesive te ndryshme te NDC-ve. Ne se NDC-te do te mbivendosen atehere duke u zmadhuar siperfaqet do te zvogelohen veshtiresite ne kuptimin e dialling lokal.

Tabela e meposhtme tregon numer formimin lokal per rajonin e Tiranes.

Numri thirres	Numri i thirrur	Algoritmi i numer formimit lokal
4 2YYY YYY	4 2YYY YYY nga rajonet tjere	2YYY YYY 04 XYYY YYY
4 3YYY YYY	4 3YYY YYY 4 tjere	3YYY YYY 04 XYYY YYY
4 4YYY YYY	4 4YYY YYY nga rajonet tjere	4YYY YYY 04 XYYY YYY
4 5YYY YYY	4 52YYY YYY nga rajonet tjere	5YYY YYY 04 XYYY YYY
4 6YYY YYY	4 6YYY YYY nga rajonet tjere	6YYY YYY
47 YYY YYY	47 YYY YYY nga rajonet tjere	7YYY YYY 04 XYYY YYY
48 YYY YYY	48 YYY YYY nga rajonet tjere	8YYY YYY 04 XYYY YYY
49 YYY YYY	49 YYY YYY nga rajonet tjere	9YYY YYY 04 XYYY YYY

Tabela e meposhtme tregon numer formimin lokal per rajonin e Shkodres.

Numri thirres	Numri i thirrur	Algoritmi i numer formimit lokal
268 2YYYY	268 2YYYY	268 2YYYY
Qender-Gruemire	268 tjere	268 XYYYY
268 3YYYY	268 3YYYY	268 3YYYY
Qender-Gruemire	268 tjere	268 XYYYY
.....

Tabela e meposhtme tregon numer formimin midis rajoneve Shkoder -Tirane.

Numri thirres	Numri i thirrur	Algoritmi i numer formimit
4 2YYY YYY	268 2YYYY	02682YYYY
Tirane	268 te tjere	0268XYYYY
	Qender-Gruemire	
4 3YYY YYY	22 2YYYYY	022 2YYYYY
Tirane	22 tjere	022 XYYYYY
	Shkoder (qytet)	

Aneksi 1, bashkengjitur ketij dokumenti, jep strukturen e re te zonave gjeografike (rajonet) dhe Numeracionin e riorganizuar sipas rajoneve perkatese.

Pyetje 1: A jeni dakort me kete opinion te AKEP? Ne se jo lutemi komentin Tuaj per kete ceshjte.

7.1.5 Tarifat dhe numeracioni:

Regullimi i tarifave ne vende te ndryshme ka praktika te ndryshme duke u fokusuar kryesisht ne rregullimin ne nivelin e shumices per sherbimet baze te interkoneksionit, por me qellim

kryesor reflektimin e ketij rregullimi ne nivelin e perdoruesit fundor, apo sic njihet ndryshe ne nivelin e pakices.

Sipas topologjise se rrjetit PSTN te Albtelecom, si dhe tarifimit te sherbimeve te interkoneksionit aktual sipas segmentimit (lokal, njefishte dhe dyfishte) per terminimin dhe origjinimin e thirrjeve, si dhe (segmentet e njefishte dhe dyfishte) per tranzitim thirrjesh. Arsyet e nje segmentimi te tille, por edhe tarifimi perkates sipas ketij segmentimi ka percaktuar edhe tarifate e thirrjeve per perdoruesin fundor, duke i kategorizuar ne lokal, rajonal, kombetar, drejt celulareve, nderkombetare si dhe fashet orare peak dhe off-peak.

Por procesi i migrimit te rrjetit nga PSTN ne NGN/NGA, dhe faza aktuale ku ndodhet ky proces ka bere te mundur te konsiderohen edhe ndryshimi i strukturese se kostove te sherbimeve baze te interkoneksionit (terminim/origjinim dhe tranzitim), duke shtuar mundesine per te konsideruar gjithnje e me shume reduktimin deri ne eliminimin e ndryshimeve te tarifave qe kane si shkak distancen gjeografike.

Per te shpjeguar lidhjen ndermjet numeracionit dhe tarifave, e rendesishme eshte te konsiderohet relacioni i krijuar ndermjet kodit te zones dhe distances se konsideruar per percaktimin e tarifimit te thirrjeve.

Sjellim ne vemendje qe, thirrjet ndermjet numrave nen te njejtin kod zone jane tarifuar gjithmonë si thirrje lokale, ndersa per thirrjet midis kodeve te zonave të ndryshme jane tarifuar gjithmonë si thirrje në distancë. (p.sh. kjo do të thotë se thirrjet midis abonentëve të vendosura të dyja anët e kufirit të një kodi zone ku distanca midis abonentëve është mjaft e shkurtër janë tarifuar gjithmonë si thirrje ne ne distance).

